



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.22/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Naim Mehulli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbarduesit Privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , duke vendosur lidhur më ankesën e paraqitur nga , me seli në , lidhur me veprimet përmbardimore në lëndët përmbardimore P.nr.321/2025, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Mimoza Blakaj, personalisht Përmbarduesi Privat, dhe i autorizuari i palës ankuese me datën 15.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET ankesa e datës 07.11.2025 e paraqitur nga pala ankuese, me seli në , si e pa bazuar.

II. Përmbarduesi Privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P.nr.321/2025.

A r s y e t i m

Me datën 07.11.2025, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbarduesit Privat, me të cilën pretendon se përmbarduesi nuk ka vazhduar procedurën përmbardimore vetëm se nuk i ka paguar shpenzimet përmbardimore

përkundër njoftimit të përmbaruesit se nuk i konteston faturat por momentalisht i ka llogarit e bllokuara dhe në momentin kur të lirohen llogarit do ti paguaj faturat, me këtë rast i njëjti ka shkel nenin 367 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore . I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbaruesi privat ti shqiptohet ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje 3 muaj deri në 1 vit. Përfaqësuesi i palës ankuese në seancën e dt.15.12.2025 ka mbetur në tersi sipas ankesës me propozime të njëjta.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë dhe mbetet në tërësi pran raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 15.12.2025.

Përmbaruesi privat në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 15.12.2025, e ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e palës ankuese, duke pretenduar që asnjë dispozitë ligjore nuk është shkelur në rastin konkret. Ka shtuar se kreditorit vetëm ja ka përkujtuar obligimin për pagesën e taksave për këtë rast por nuk e ka ndaluar marrjen e urdhrit përmbarimor ku e kam lejuar të njëjtin me dt.29.09.2025, pastaj zyrtare i palës ankuese ka kërkuar të shtyhet përmbarimi dhe se me dt.06.10.2025 me kërkesë të kreditorit është shtyrë përmbarimi deri me dt.31.10.2025 dhe se pala ankuese akoma pa kaluar afati për të cilin e kam pezulluar procedurën kanë dal përmes policisë e kanë ekzekutuar aktvendimin.

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbarimore, i përcakton shkeljet përmbarimore për përmbaruesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbaruesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbaruesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbaruesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbaruesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbaruesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbaruesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;

- 1.9. Nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lartcitur, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Komisioni Disiplinor, vlerëson se Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet e lart cituar të nenit 367 të LPP-së, sepse në këtë rast përmbaruesi privat nuk ka bërë ndonjë tejkallim të autorizimit të dhënë me ligj sepse procedimi i kësaj çështje përmbarimore dhe kërkesa për pagesën e shpenzimeve fillestare për përmbarim nga ana e përmbaruesit në këtë rast është bere sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR.01/2022 Për Tarifat Për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve Për Përmbaruesit Privat. Po ashtu përmbaruesi privat në këtë rast ka vepruar konform nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit Për Procedurën Përmbarimore ku është përcaktuar: “Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori”, ndërsa me paragrafin 2 të nenit të lartcekur përcaktohet: “Shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni, propozuesi i përmbarimit ka për detyrë t’i parapaguj brenda afatit të caktuar nga organi përmbarues. Organi përmbarues do ta pezulloj përmbarimin po qe se nuk parapaguhet shpenzimet brenda afatit të tillë. Po qe se brenda afatit të dhënë nga organi përmbarues nuk parapaguhet shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë”, prandaj komisioni vlerëson se përmbaruesi privat, nuk është përgjegjëse për veprimet e ndërmarra përmbarimore në rastin lëndor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr.22/2025 datë 15.12.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Naim Mehulli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.